



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEČ



## ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

### Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 24.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.07.2024 me titull Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve RIVLERSIM Nr. të Prok: 635-24-4883-2-2-1 dhe nr i brendeshen 635-24-032-221 nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C. . të datë 23.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve RIVLERSIM Nr. të Prok: 635-24-4883-2-2-1 dhe nr i brendeshen 635-24-032-221 nxjerr:

kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të datës 19.07.2024 te publikuar ne platëformen elektronike të E- Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 19.07.2024

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.. me daten 23.07.2024 , ka parashtruar kërkesen për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve RIVLERSIM me Nr. të Prok: 635-24-4883-2-2-1 nr i 635-24-032-221 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 24.07.2024 ka shqyrtuar kërkesen në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kerkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesen tuaj në platformen elektronike të datës: 23.07.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesen tuaj, dhe ka ardhur ne perfundim se nejeta eshte e pa bazuar.,

## Pretendimet e O,E 1

### 1. Shkelja e tarifave te BQK-se

Pozicionet ne dosje te tenderit me nr 20,21 & 28 ne te cilat eshte bazuar ankesa ne OSHP qe kemi bere shkelje te tarifave ,ne dosje te tenderit nuk eshte specifikuar qe a jane urban apo nderurban keta autobus ,per kete arsye edhe OE I cili eshte shpallur fitues nuk ka pas info dhe nuk eshte kerkuar scarime shtese per kete ,prandaj kjo si pike mbetet per te diskutuar per shkak qe ligji I prokurimit kerkon qe infot te jene te gjitha ne dosje te tenderit ,dhe jo te mirren nga informatore te tjere .

## Pergjegjia nga A,K 1,


Ju njoftojm se ne si A,K dhe Komisioni i RI-Vlersues se ka vepruar konform vendimit te ekspertit te OSHP-se sipas tarifave te BQK-se . dhe LPP-se ,

Ju njoftojm se ju nuk keni respektuar Tarifat Zyrtare te BQK-se ,te publikuara ne web faqe te BQK-se dhe ne si AK kemi respektuar vendimin e ekspertit shqytues andaj me keqardhje ju njoftojm se pretendimet e juaja jan te pa bazuara

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Me respekt  
Milot Gashi  
Menaxher i Prokurimit KK-Peje



Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Florije Rexhepi</b>	<b>28.06.2024</b>	<b>05.07.2024</b>	<b>2024/0533</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.06.2024, OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0533, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "077 Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve" me nr. të prokurimit: "635-24-4883-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: sherbim, vlera e parashikuar e kontratës: 86,317.17€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 17.05.2024 data e hapjes së ofertës; 29.05.2024, data e vendimit për dhënien e kontratës: 06.06.2024, data e njoftimit të me letër standarde: 06.06.2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Neni 1 i LPP-së  
 Neni 7 i LPP-së  
 Neni 52 i LPP-së  
 Neni 59 i LPP-së  
 Neni 60 i LPP-së  
 Neni 69 i LPP-së  
 Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
 Tarifat e Bankës Qendrore të Kosovës

### KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<b>Përshtatshmëria profesionale:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH-së Kërkesa 3. Licenca për veprimtarinë e regjistruar – të kësaj natyre prej BQK-së	Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje Dëshmia 3 Kopje Licences për veprimtarinë e regjistruar – të kësaj natyre prej BQK-së
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 170.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.	Dëshmia 1 Deklaratat e dorëzuara Administratën Tatimore të Kosovës apo në vend të themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

### RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i përgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontrate është i përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se për dhënie të kontratës ka dorëzuar në OSHP, me pretendimin se AK-ja nuk i ka respektuar procedurat e vlerësimit të ofertave, konkretisht i njëjti pas pranimit të vendimit B58 ka kërkuar qasje në ofertën e rekomanduarit për kontratë dhe OE ankues pasi i ka analizuar çmimet e vendosura në paramasën e OE të rekomanduar për kontratë ka vërejtur se i njëjti nuk i ka vendosur çmimet sipas tarifave të Bankës Qendrore të Kosovës.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është njoftuar nga AK-ja me letrën standarde të tenderuesit të pasuksesshëm, pasi që e ka tejkalluar vlerën e parashikuar.

Në ankesën e tij OE ankues i ka përmendur pozicionet e kategorisë së autobusëve urban dhe nderurban, ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë në pozicionet nr: 20 - ka vendosur çmimin prej 460€, ndërsa sipas tarifave të BQK-se, primi baze për autobusët nderurban është 470€ + 5 € për çdo ulësë, pozicioni nr: 21 - ka vendosur çmimin prej 422€, ndërsa sipas tarifave të BQK-se, primi baze për autobusët nderurban është 470€ plus 5€ për çdo ulësë dhe

pozicionin nr: 28 - ka vendosur çmimin prej 408€, ndërsa sipas tarifave të BQK-se, primi baze për autobusët nderurban është 470€ plus 5€ për çdo ulëse.

Poashtu OE ankues pretendon se të kategoria e veturave OE i rekomanduar për kontratë, në pozicionet nr: 30, 33, 38, 39, 47, 73 dhe 74, nuk i ka respektuar tarifat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku përfshihen taksa administrative, taksa ekologjike, taksa rrugore të cilat përcaktohen në baze të peshës së automjetit, pra sipas OE ankues dallojnë tarifat për automjetet nën 3.5T dhe mbi 3.5T.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës ka vërejtur se OE ankues të njëjtin pretendim e ka parashtruar në kërkesën për rishqyrtim dhe në përgjigje AK-ja është deklaruar se në e kemi respektuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës dhe nuk i është përgjigjur konkretisht në tarifat e BQK-se dhe tarifat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, kërkesë kjo e vendosur nga AK-ja në paramasë dhe parallogari.

Eksperti shqyrtues, me datën: 04.07.2024, i është drejtuar me shkrim AK-Komunës së Pejës, për të sqaruar faktin se a janë respektuar tarifat e BQK-se lidhur me çmimet e sigurimeve dhe në përgjigje AK-Komuna e Pejës ka deklaruar se: sa i përket tarifave të BQK-se, mbetet në përgjegjesin e OE që ka ofertuar çmimin.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues me rastin e dorëzimit të ankesës në OSHP, ka dorëzuar edhe listën e tarifave të vendosura nga BQK-ja për të gjitha automjetet dhe pretendimi i OE ankues se i rekomanduar nuk i ka respektuar këto tarifa qëndron dhe njëherit kërkon nga autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të analizoje çmimet e pretenduara nga OE ankues bazuar në tarifat obligative të BQK-se dhe njëherit të analizoje edhe çmimet e ofruara nga i rekomanduar për kontratë lidhur me tarifat e Ministrisë së Brendshme bazuar në peshën e automjetit sepse, kërkesën për taksat, kontrollat teknike të automjeteve autoriteti kontraktues e ka kërkuar në paramasë dhe parallogari.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "077 Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve" me numër të prokurimit: "635-24-4883-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.**

**Florije Rexhepi**

